



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1341/5 prot.

Datë 03.08.2023

V E N D I M
Nr. 716/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” DSHH në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “*Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika’*”, me fond limit 325,049,984 (*treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër*) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” DSHH.
Adresa: Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi “Usluga”, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.
Adresa: Rruga “Donika Kastrioti”, Peshkopi.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK
Adresa: Rruga “Sule Bega”, Nd. nr. 32. Hyrja. 8, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.04.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Dibër ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

II.2. Në datën 10.05.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.05.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alko Impex General Construction” DSHH	299.105.123,33 lekë	skualifikuar
2. “Ndregjoni” SHPK	317.170.464	lekë kualifikuar
3. “Kupa” SHPK	320.242.599	lekë skualifikuar
4. “ASI-2A CO” SHPK	322.169.997	lekë skualifikuar
5. “Valona Konstruksion” SHPK	324.036.695	lekë skualifikuar
6. “Frontier Construction” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

II.4. Në datën 30.05.2023 operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” DSHH është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

1- Operatori ekonomik “ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3., të kritereve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, sipas së cilës “Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën 130,019,994 (Njëqind e tridhjetë milion e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht: 650,099,968 (Gjashtëqind e pesëdhjetë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik “ ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k., ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratën Nr.2832/5Prot date 11.06.2019 me object Rikonstruksion i shkolles së mesme profesionale 26 Marsi Kavaje nënshkruar nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik Alko Impex Shpk & 2 T Shpk , ku sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive Nr. 2703.Rep Nr. 2050 Kol date 16.04.2019, shoqëria Alko Impex Shpk ka marrë përsipër 86.5 % të punimeve. Referuar situacionit progresiv Nr.4 (Përfundimtar) ka kryer punime ne vleren 106,395,557 leke pa tvsh. Formulari i vlersimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të

dokumentave standarte te tenderit , nuk dëshmon që shoqëria ALKO - IMPEX -General Construction Sh.p.k ka qenë Bashkimi Operatoresh Ekonomik me shoqërin 2 T Shpk

2. Kontratën Nr. 1643/6 date 22.05.2017 me objket Rikonstruksion Shkolla e Mesme Profesionale Ali Myftiu Elbasan me vlerë 80,896,117 lekë pa tvsh.

3. Kontraten Nr. 2317/4 Prot me objekt “Rehabilitim i kullës së kontigjences” date 27.12.2017 me vlerë 41,547,358 lekë pa tvsh.

4. Në lidhje me Kontraten Nr. 3890/8 date 07.09.2017 me objket Masat mbrojtëse në anën e majtë të rrjedhës së lumit drin , në biefin e poshtëm të digës së fierzes nuk është as në natyrë as në kompleksitet as në metodologji punimesh e ngjashme me objektin që prokurohet , kjo referuar dhe zërave të punimeve që ka kryer OE “ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k., në objektin e paraqitur, si rrjedhoj nuk mund të konsiderohen punime të ngjashme me objektin që prokurohet. Operatori ekonomik “ ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k punë të ngjashme me vlera totale 228,839,032 lekë pa tvsh.

Nuk plotes asnjërin nga kushtet e kerkuar ne DST (Pika 2.3./a dhe Pika 2.3./b).

2- Operatori ekonomik ALKO - IMPEX -General Construction SH.P.K nuk plotëson pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim , të dokumenteve të tenderit. Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin) dhe OE rezulton se për punonjësit e specializuar si më poshtë: 2 (dy) Arben Reci, Fates Lita - Instalues dhe riparues te sistemeve ftohese- ngrohese; ka deklaruar se deshmitë profesionale janë të lëshuara nga subjekti AQScert, me NUIS L31511026K. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Kete qendrim ka mbaajtur edhe KPP ne vendimin nr. 441/2020, ku citohet si vijon:

Pra rezulton se dokumentet e paraqitura për dy punonjësit pllakashtrues, në zbatim të pikës 8 si më sipër cituar nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar Certifikatat e Trajnimit për “Kurs Trajnimi për pllakashtrues”, nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në perputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqiperise." Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmeri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:

- Hidraulik (Kadri Fusha)
- Elektricitist (Sali Allmeta)
- Hekurkthyes (Artan Jonuzi, Ramazan Emini, Englison Demiri)
- Hekurpunues (Lavdrim Tota, Entil Guga)
- Karpentier (Krenar Plakalli , Arben Deliu)
- Betonues (Arben Lecini, Klodian Ramka)
- Elektromekanik (Islam Demiri)
- Mekanik (Hoselito Seferi)
- Specialist gipsi , sistemet e thata në ndërtesa (Hamid Tafa, Mariglen Ramazani, Florid Toska, Riza Kola)
- Punonjes Duroalumini (Ylli Xhepa)
- Muratore (Agron Kullolli, Bledar Cela, Xhemail Emini, Abaz Kullolli, Ramadan Kruja, Hajri Tafani)

- Suvatues (Albert Murataj, Erlin Xhafai, Ervin Shehu)

- Hidrozolues (Ermal Tafaj, Hekuran Balloshiti, Zyhdi Elezi, Zenel Gjini)

- Bojaxhi (Derman Cangeli, Luan Qekai, Syrjan Qekai, Xhuliano Hasani, Edmond Sula)

- Shtrues pllakash (Jonuz Leci, Ylli Driza, Fatmir Alushi, Haxhi Seferi, Fatos Bunoca, Luan Ali) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “TCPE”, me NUIS L52031020F. Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:

- Hidraulik (Sokol Bufi)
- Instalues dhe riparues te sistemeve ftohese- ngrohese (Emiljano Beba)
- Duroalumini (Albi Lloga, Muhamet Isallari) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “HTM”, me NUIS K97006004D.

Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:

- Elektricitist (Servet Gjuzi, Shkelqim Paja)
- Hekurkthyes (Megli Cano, Venture)

- Hidraulik (Kledi Myrto, Kujtim Shehu)
- Karpentier (Sokol Peqini, Venture)
- Punonjes Duroalumini (Syrja Shena)
- Saldator (Besnik Spahiu, Rustem Isha, Daniel Kruja), janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti FUSION EV sh.p.k., me NUIS M11314044Q.

Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këte qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-ve dhe deklaratës për stafin), rezulton se punonjësit e specializuar:
 - Karpentier (Uesli Shehaj)
 - Hidraulik (Memo Lila)
 - Bojaxhi Klajdi (Hametaj)
 - Specialist gipsi, sistemet e thata (Elia Shena)
- Instalues dhe riparues të sistemeve ftohese- ngrohese (Adriatik Gogo, Leonard Sulka) janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve të Avancuara – QTA me NUIS L61325037A.

Lidhur me këtë certifikatë, KVO verifikoi në QKB nga ku rezulton se kjo shoqëri nuk është e licencuar për të ofruar dëshmi kualifikimi për këtë profesion dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

3- Operatori ekonomik “ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e pikës 2.4.3 dhe 2.4.4 , të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit konkretisht:

- Për materialet elektrike mungon autorizimi distributorit Bosch, LTD, Canovat, Schneider Electric, ITC, katalog celesa elektrik, Priza elektrike shuko, Panele elektrik, Automat, Kamera etjer. I gjithë informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ALKO - IMPEX - General Construction ” sh.p.k nuk është në gjuhën shqipe,
- Për materialet hidraulike ka paraqitur kontratë furnizimi date 14.09.2022 që përfundon me date 14.09.2023 , neni 3 pika 2 shprehet qartë që palet bien dakord që afati i kontratës se qerese mund të zgjatet duke njoftuar paraprakisht njëra tjetrën në këtë rase kemi të bëjmë me kontratë furnizimi jo qiraje . Në sistem ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Grundfos Srbija d.o.o. për pompa dhe Centrometal për kaldajë (Të pa përkthyer në gjuhën shqipe). Mungo autorizimi prodhuesit për distributorin P.F Haki Sinan nga prodhuesit SABIANA S.p.A, IMQ S.p.a, VAREM S.p.A, BONIMINI S.r.l, Varem S.p.a, ITAP Spa, Comisa srl, Varem S.p.a dhe Ferplast. Për materialet për furnizimin me uje, Pompe për sistemin MNZ mungojnë Skedat

teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimet nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance. I gjithë informacioni i paraqitur nuk është në gjuhen Shqip sipas pikes 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip.

- Për materialet hidraulike HVAC nuk ka paraqitur dokumentacion për Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik), NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHTESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrj Derg/Rikthim: 1500m³/h , Rezervuar per karburant mungon autorizim prodhuesi, Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance. Për materialet Ene zgjerimi ka paraqitur vetem katalog nga Varem S.p.a mungo autorizimi prodhuesi, Certifikatë Konformiteti CE/Deklarata Performance.

- Për materialet Bojë Akrilike Bojë vaji mungo certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike, për Boje Hidroplastike certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale. Për Pllakë shtrimi grez porcelanato Veshje me pllakë majolike nuk ka paraqiten Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.

- Për materialet plakë gipsi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kerkesave te dokumenteve standarde te tenderit mungo autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributor, me të cilin prodhuesi / distributori autorizon kompaninë ofertuese, Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.

- Për materjalet durale ka paraqitur Autorizim nga shoqëria Usluga Shpk dhe katalog nga shoqëria turke DEMİRTAŞ METAL A.Ş, bazuar ne dokumentat që janë paraqitur në sistem shoqëria Usluga Shpk nuk verteto që është prodhues - Për materjalet Ashensor informacioni i paraqitur nuk është në gjuhen Shqip sipas pikes 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip.

II.5. Në datën 06.06.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 12.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1341 prot, datë 12.06.2023 e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” DSHH, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1341/2 prot., datë 13.06.2023, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” DSHH kundërshton me anë të ankesës me nr. 1341 prot, datë 12.06.2023.

II.6.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 536/2 prot., datë 15.06.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1341/3 prot., datë 16.06.2023 me objekt “Kthim-përgjigje”, është depozituar nga

autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se me Vendimin Nr. 1, datë 15.06.2023 autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës mos pranimit e saj.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 16.06.2023 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 1341/4 prot “*Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar Ndregjoni SHPK*”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 1341 prot, datë 12.06.2023, paraqitur nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” DSHH ka lidhje me vendimet dhe veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118 pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar, parashikohet se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me

parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”, Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” DSHH në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi me pretendimit se: “Operatori ekonomik “ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e pikës 2.4.3 dhe 2.4.4 , të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit konkretisht: - Për materialet elektrike mungon autorizimi distributorit Bosch, LTD, Canovat, Schneider Electric, ITC, katalog celesa elektrik, Priza elektrike shuko, Panele elektrik, Automat, Kamera etjer. I gjithë informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ALKO - IMPEX -General Construction ” sh.p.k nuk është në gjuhen shqipe; - Për materialet hidraulike ka paraqitur kontrate furnizimi date 14.09.2022 që përfundon me date 14.09.2023 , neni 3 pika 2 shprehet qarte që palet bien dakord që afati i kontrates se qerese mund të zgjatet duke njoftuar paraprakisht njëra tjetrën në këtë rase kemi te bëjmë me kontrate furnizimi jo qiraje. Në sistem ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Grundfos Srbija d.o.o. për pompa dhe Centrometal për kaldaj (Të pa përkthyer në gjuhen shqipe). Mungo autorizimi prodhuesit për distributorin P.F Haki Sinan nga prodhuesit SABIANA S.p.A, IMQ S.p.a, VAREM S.p.A, BONIMINI S.r.l, Varem S.p.a, ITAP Spa, Comisa srl, Varem S.p.a dhe Ferplast. Për materialet per furnizimin me uje, Pompe per sistemin MNZ mungoj Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance. I gjithë informacioni i paraqitur nuk është në gjuhen Shqip sipas pikes 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip; - Për materialet hidraulike HVAC nuk ka paraqitur dokumentacion për Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik), NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHTESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrj Derg/Rikthim: 1500m³/h , Rezervuar per karburant mungon autorizim prodhuesi, Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance. Për materialet Ene zgjerimi ka paraqitur vetem katalog nga Varem S.p.a mungo autorizimi prodhuesi, Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance; - Për materialet Bojë Akrilike Bojë vaji mungo certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike, për Boje Hidroplastike certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale. Për Pllakë shtrimi grez porcelanato Veshje me pllakë majolike nuk ka paraqiten Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi; - Për materjalet plakë gipsi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kerkesave te dokumenteve standarde te tenderit mungo autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributor, me të cilin prodhuesi / distributori autorizon kompaninë ofertuese, Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi; - Për materjalet durale ka paraqitur Autorizim nga shoqëria Usluga Shpk dhe katalog nga shoqëria turke DEMİRTAŞ METAL A.Ş, bazuar ne dokumentat që janë paraqitur në sistem shoqëria Usluga Shpk nuk verteto që është prodhues - Për materjalet Ashensor informacioni i

paraqitur nuk është në gjuhën Shqip sipas pikës 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në shtojcën nr. 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 2.4.4 “Kapaciteti Teknik” në dokumentet standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.4. Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e mëposhtme duhet të paraqiten:

1. PUNIMET ELEKTRIKE

- Për materialet elektrike Percjelles bakri izolim PVC , Kabell elektrik bakri FG7OR , Celes elektrik, Priza elektrike shuko, Panel elektrik, Automat magnetik termik , Ndriçues plafonier led 60x60, Ndriçues plafonier led, Tabele "EXIT" te ndriçuara llampe led , Ndriçues rrugor led, Pajisje energjie UPS/3F-30kVA, Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, Sensor Optik Temperature, Sensor Optik Tymi, Buton per thirrje manuale i adresueshem, Sirene per brenda ndertese optike dhe akustike, NVR 32 Kanale, 16 PoE,4K, HDD 2x4TB SEAGATE, full HD, Kamera Bullet, Kamera Dome **duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

2. PUNIME HIDRAULIKE

- Për materjalet hidraulike Minisaracineska 1/2" , Saracineska bronzi , Tuba dhe Rakorderi PP3 HTEM , Tuba te brinjzuar HDPE SN8 , Pompe per furnizimin me uje, Pompe per sistemin MNZ **duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

3. PUNIME HVAC

- Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik).Kapaciteti ftohes / ngrohes: 453 / 503 kË .Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -2°C -Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : 210 kË / 400V / 351A / 3 F ~ 50Hz . Kit hidraulik (ene zgjerimi, pompe qarkullimi inverter, valvol, etj.)Sensor komplet. dhe mbrojtje atomatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator. ". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmëtimi CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- “Kaldaje e ujit te ngrohte HVAC Karakteristikat Teknike :- Fuqia termike min/max : 468/720 kË, - Dimensioni tubi dergim / kthim : DN 100 / DN 100- Dimensioni i kanalit te tymit : Ø 340 mm- Presioni max: - 6 bar-Humbja ne shkarkimin e tymit: 4.5 mbarI kompletuar me valvola nderprerese, sigurie , shkarkimi, manometer, termometer,sensor elektronik etj. ". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmëtimi CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

- "Ene zgjerimi Karakteristikat Teknike:-Autokllave me membranë-Presioni max : 10 bar, -Kapaciteti 50 lit -De = 407 mm -H = 528 mm -Lidhjet: F Ø 3/4" **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- "NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHITESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrja Derg/Rikthim: 1500m³/h , Renia Presioni: 120 Pa , Rendimenti : 55% , Fuqija Elektrike: 2x550Ëat , Grupi filtrave: F7/G3 , Seksioni i Trajtimet te Ajrit (Baterite) , Kapacitetit Termik Ng: 7.5 kË , Kapaciteti Termik Ft: 6.8 kË , Kompletuar me gjithë elementet e nevojshem per montim. Sidhe sistemin e kontrollit.". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- Rezervuar per karburant, me bokaporte te fllaxhuar, me pusete furnizimi dhe me te gjitha lidhjet e duhura ,çertifikuar per presion te brendshem 1.0 bar.I kompletuar me te gjithë aksesoret :(me nivel mates elektrik, saraçineske bllokimi, tub i mbushjes,tub i dergimit, tub i ajrimit , etj). Me dalje nga poshte, me fileto 3"F. **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi Dokumentin e testimet te lyerjes se jashtme , dokumenti i testimet hidrostatik certifikate kalibrimi ; certifikaten e inspektimit te materialit të perdorur.**

4. PUNIME BOJATISJE

- **Bojë Akrilike** produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente duhet te paraqiten:**Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimet nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike.**
- **Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalent . **Duhet te paraqiten: Katalogët/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimet nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.**
- **Bojë hidromat** të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. **Duhet te paraqiten: Katalogët/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimet nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Bojë vaji** Boja të jetë me bazë rezinë alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë dhe e tretshme në ujë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike dhe druri. **Duhet te paraqiten: Katalogët/skedat teknike te**

shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike.

5. PUNIME SHITESASH

- ***Hidroizolues Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji. Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.***
- ***Kolle Speciale Antilagështirë Ngjitës thiksotropik, elastik, i gatshëm për përdorim, me bazë shpërndarjen ujore të estereve poliakrilike dhe shtesa të veçanta kategoria D2TE sipas EN 12004. (ose ekuivalente). Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 12004:2007 +A1:2012 ose ekuivalente. Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.***
- ***Pllakë shtrimi grez porcelanato. Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmangët rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes. Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.***
- ***Veshje me pllakë majolike, Formatit 30x60 cm x 10mm ose 60x60 (mbas kërkesës), Porcelain ,cilësi e parë. Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.***

6. PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

- ***Suva (Llac mbushës) - Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.***
- ***Fino Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike të kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente). Duhet të paraqiten: Katalogët/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.***
- ***Stuko patinimi - Stukoja e patinimit të jetë material i cili realizon një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke***

krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalente Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij. **Duhet të paraqiten: Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**

7. PUNIME MURATURE

- **Polisteroli.** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 131631 ose ekuivalente. **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Plakë gipsi për ambiente të brendshme** Pllakat e gipsit për ambiente të brendshme përdoren para së gjithash si veshje një shtresore në sistemet e mureve që nuk plotësojnë ndonjë kërkesë të veçantë. E përshtatshme për forma dhe distanca të ndryshme të montimit. Të ketë stabilitet të lartë edhe për konstruksionet me një veshje të vetme shtrese pllake. Përpunim të jetë i thjeshtë. Të ketë bymim dhe tkurrje e vogël si rezultat i ndryshimeve të kushteve klimaterike. **Duhet të paraqiten: Katalogë/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

8. MATERJALE DURAL

- **Materiale durale .** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 13830 ose ekuivalente. **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente.**

9. ASHENSORI

- Ashensor sherbimi spitalor; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajttese 1600 kg; me kapacitet; me 5 ndalesa; **Duhet të paraqiten : Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , certifikatë per ashensorët e personave sipas standardit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombëtare.**
- Ashensor sherbimi ; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajttese 1200 kg; me 5 ndalesa; **Duhet të paraqiten : Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , çertificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombtare.**

10. GAZ MJEKSOR

- *Certifikatë ISO 13485:2016 'Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Aparateve Medicinale' të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar të prodhuesit me objekt " Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik.*
- *Certifikate 45001:2018 sistem menaxhimi i shendetit dhe cilesise ne pune me objekt " Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore , sistemet e vakumit dhe gazit anestezik.*
- *Certifikate ISO 9001-2015 per sistemin e menaxhimit te cilesise me objekt " Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik.*
- *Paisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 "Për paisjet mjekësore".*
- *Per te gjitha zerat ne preventiv te gazeve mjekesore duhet te paraqitet katalogu ku te jene te nenvizuara materialet e kerkuara.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" DSHH, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Kontratë furnizimi për ashensor pdf.
- Katalog gaz mjekësor compressed pjesa 1. pdf
- Katalog gaz mjekësor compressed pjesa 2 pdf.
- Kontratë furnizimi gaz mjekësor pdf.
- Kontratë furnizimi gipsi suvatim veshje pdf.
- Kontratë furnizimi dekoll pdf.
- Lista e Produkteve 2019 pdf.
- Katalog Termodekore 1 pdf.
- Katalog dekoll 2019 pdf.
- Kontratë furnizimi Sinani Kondicionim pdf.
- Sinani pjesa 1 pdf.
- Sinani pjesa 2 pdf.
- Sinani pjesa 3 pdf.
- Autorizim Prodhuesi Usluga compressed (1) pdf.
- Kontratë furnizimi vega pdf.

- Elektrike dhe kundra zjarrit pdf.
- Autorizim + dokumentacion pdf.
- Kontratë furnizimi brunes pdf.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efijencës së energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo

gjqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa

sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë

ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton se, duke u kthyer tek arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues të cilat i kundërshton në ankesën e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues ka të bëjë përkatësisht me pretendime për mospërmbushjen e kriterit 2.4.4 në të cilin është kërkuar se për **1. Punimet Elektrike Për materialet elektrike Percjelles bakri izolim PVC , Kabell elektrik bakri FG7OR , Celes elektrik , Priza elektrike shuko , Panel elektrik , Automat magnetik termik , Ndriçues plafonier led 60x60 , Ndriçues plafonier led , Tabele "EXIT" te ndriçuara llampe led , Ndriçues rrugor led , Paisje energjie UPS/3F-30kVA , Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar , Sensor Optik Temperature , Sensor Optik Tymi , Buton per thirrje manuale i adresueshem , Sirene per brenda ndertese optike dhe akustike , NVR 32 Kanale, 16 PoE,4K, HDD 2x4TB SEAGATE, full HD , Kamera Bullet , Kamera Dome duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance. 2. Punime Hidraulike Për materialet hidraulike Minisaracineska 1/2" , Saracineska bronzi , Tuba dhe Rakorderi PP3 HTEM , Tuba te brinjzuar HDPE SN8 , Pompe per furnizimin me uje , Pompe per sistemin MNZ duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance. 3. Punime Hvac Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik).Kapaciteti ftohes / ngrohes: 453 / 503 kË .Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -2°C -Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : 210 kË / 400V / 351A / 3 F ~ 50Hz . Kit hidraulik (ene zgjerimi, pompe qarkullimi inverter, valvol, etj.)Sensor komplet. dhe mbrojtje atomatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator. ". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.** "Kaldaje e ujit te ngrohte HVAC Karakteristikat Teknike :- Fuqia termike min/max : 468/720 kË, - Dimensioni tubi dergim / kthim : DN 100 / DN 100- Dimensioni i kanalit te tymit : Ø 340 mm- Presioni max: - 6 bar-Humbja ne shkarkimin e tymit: 4.5 mbarI kompletuar me valvola nderprerese, sigurie , shkarkimi, manometer, termometer,sensor elektronik etj. "**Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.** "Ene zgjerimi Karakteristikat Teknike:-Autokllave me membranë-Presioni max : 10 bar, -Kapaciteti 50 lit -De = 407 mm -H = 528 mm -Lidhjet: F Ø 3/4"**Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti****

CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. “NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHTESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrja Derg/Rikthim: 1500m³/h , Renia Presioni: 120 Pa , Rendimenti : 55% , Fuqija Elektrike: 2x550Ëat , Grupi filtrave: F7/G3 , Seksioni i Trajtimit te Ajrit (Baterite) , Kapacitetit Termik Ng: 7.5 kË , Kapaciteti Termik Ft: 6.8 kË , Kompletuar me gjithë elemntet e nevojshem per montim. Si dhe sistemin e kontrollit.”**Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.** Rezervuar per karburant, me bokaporte te fllaxhuar, me pusete furnizimi dhe me te gjitha lidhjet e duhura ,çertifikuar per presion te brendshem 1.0 bar. I kompletuar me te gjithë aksesoret :(me nivel mates elektrik, saraçineske bllokimi, tub i mbushjes,tub i dergimit, tub i ajrimit , etj). Me dalje nga poshte, me fileto 3"F. **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi** Dokumentin e testimiit te lyerjes se jashtme , dokumenti i testimiit hidrostatik çertifikate kalibrimi ; çertifikaten e inspektimit te materialit të perdorur. **4. Punime Bojatisje Bojë Akrilike** produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. **Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike. Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalent . **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente** **Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale. Bojë hidromat** të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. **Duhet te paraqiten: Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Bojë vaji** Boja të jetë me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë dhe e tretshme në ujë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike dhe druri. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike. 5. Punime Shtresash Hidroizolues** Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës per tarrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji. **Duhet te paraqiten: Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Kollë Speciale Antilagështirë** Ngjitës thiksotropik, elastik, i gatshëm për përdorim, me bazë shpërndarjen ujore të estereve poliakrilike dhe shtesa të veçanta kategoria D2TE sipas EN 12004. (ose ekuivalente). Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 12004:2007 +A1:2012 ose ekuivalente. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. Pllakë shtrimi grez porcelanato.** Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmangët rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë**

Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. Veshje me pllakë majolike, Formati 30x60 cm x 10mm ose 60x60 (mbas kërkesës), Porcelain ,cilësi e parë. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. 6. Punime Suvatimi Dhe Veshje Suva (Llac mbushës) - Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohej receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1(ose ekuivalente). Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Fino Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente). Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Stuko patinimi - Stukoja e patinimit të jetë material i cili realizon një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalente Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. 7. Punime Murature Polisteroli. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 131631 ose ekuivalente. Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Plakë gipsi për ambjete të brendshme Pllakat e gipsit për ambjete të brendshme përdoren para së gjithash si veshje një shtresore në sistemet e mureve që nuk plotësojnë ndonjë kërkesë të veçantë. E përshtatshme për forma dhe distanca të ndryshme të montimit. Të ketë stabilitet të lartë edhe për konstruksionet me një veshje të vetme shtrese pllake. Përpunim të jetë i thjeshtë. Të ketë bymim dhe tkurrje e vogël si rezultat i ndryshimeve të kushteve klimaterike. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. 8. Materjale Dural Materjale durale . Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 13830 ose ekuivalente. Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimiit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente. 9. Ashensori Ashensor sherbimi spitalor; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajtese 1600 kg; me kapacitet; me 5 ndalesa; Duhet te paraqiten : Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , çertificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombtare. Ashensor sherbimi; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajtese 1200 kg; me 5 ndalesa; Duhet te paraqiten: Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , çertificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombtare. 10. Gaz

Mjekësor Certifikatë ISO 13485:2016 'Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Aparateve Medicinale' të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar të prodhuesit me objekt "Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik. Certifikate 45001:2018 sistem menaxhimi i shendetit dhe cilesise ne pune me objekt " Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore , sistemet e vakumit dhe gazit anestezik. Certifikate ISO 9001-2015 per sistemin e menaxhimit te cilesise me objekt " Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik. Paisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 "Për paisjet mjekësore". Per te gjitha zerat ne preventiv te gazeve mjekesore duhet te paraqitet katalogu ku te jene te nenvizuara materialet e kerkuara.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" DSHH, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin - Kontratë furnizimi për ashensor pdf. - Katalog gaz mjekësor compressed pjesa 1. Pdf. - Katalog gaz mjekësor compressed pjesa 2 pdf. - Kontratë furnizimi gaz mjekësor pdf. - Kontratë furnizimi gipsi suvatim veshje pdf. - Kontratë furnizimi dekoll pdf. - Lista e Produkteve 2019 pdf. - Katalog Termodekore 1 pdf. - Katalog dekoll 2019 pdf. - Kontratë furnizimi Sinani Kondicionim pdf. - Sinani pjesa 1 pdf. - Sinani pjesa 2 pdf. - Sinani pjesa 3 pdf. - Autorizim Prodhuesi Usluga compressed (1) pdf. - Kontratë furnizimi vega pdf. - Elektrike dhe kundra zjarrit pdf. - Autorizim + dokumentacion pdf. - Kontratë furnizimi brunes pdf, për vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterit të vecantë të kualifikimit pikën 2.4.4 të kapacitetit teknik të shtojcës 7/2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve të kualifikimit por dhe të specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Konkretisht kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e *skedave teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance*, për materialet e punimeve elektrike, hidraulike por jo vetëm, është një kërkesë pikësëpari e ekzagjeruar dhe e paargumentuar, nëse do t'i referohemi procesverbalit të argumentimit të kriterëve për kriterin

2.4.4, pasi nga shqyrtimi i argumentimit nuk konstatohet që autoriteti kontraktor të ketë argumentuar se përse kërkohet ky dokumentacion, dhe ajo që është më e rëndësishmja, a është i aksesueshëm për t'u marrë nga operatorët ekonomikë ky dokumentacion. Gjithashtu, autoriteti ka përcaktuar paraqitjen e **raporteve të testimit nga laboratore te akredituar**, por pa specifikuar nëse do të pranojë raporte testimi nga laborator kombëtar të akredituar apo dhe ndërkombëtar. Duke mos bërë një përcaktim të tillë nuk rezulton e provuar nëse në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për lëshimin e test-raporteve për të gjitha materialet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.4.4.

Së dyti, ky kriter i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor nuk është në përputhje me nenin 42 dhe nuk i shërben qëllimit të nenit 77 të LPP-së dhe nenit 39 të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar qartë kriteret e nevojshme në procedurat e prokurimit për kontratat e punëve publike, përmbushja e të cilave i jep siguri Autoritetit Kontraktor, që operatorët ekonomikë janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve në çdo rast duhet të ketë parasysh elementë të tillë si proporcionaliteti me objektin e kontratës, dobishmëria dhe nevoja që dikton vendosjen e kërkesës. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka krijuar artificia, duke kufizuar dhe ulur rrethin e pjesëmarrësve të cilët mund ta kenë të pamundur sigurimin e dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, jo për faj të operatorëve ekonomikë por për shkak se vetë institucioni publik i ngarkuar me ligj Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka akredituar asnjë trupë certifikuese për lëshimin e test-raporteve për të gjitha produktet e përcaktuara në kriterin 2.4.4. Në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, ligjvënësi jo më kot ka parashikuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”. Në rastin konkret, KPP gjykon, se ndodhet para hartimit të një kriteri i cili përbën diskriminim, pasi kërkesat në lidhje me dokumentacionin e kërkuar është tepër i ekzagjeruar dhe nuk i shërben qëllimit të objektit të punimeve që po kërkon të kryejë autoriteti. KPP vlerëson, se kriteri i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e mësipërme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kontekst përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të një kriteri i cili nuk lidhet me objektin e kontratës dhe nuk i shërben realizimit të kontratës, sjell si pasojë

paqartësi dhe konfuzion, si tek operatorët ekonomikë në lidhje me mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e tyre, por dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në proceduar e prokurimit. Në rastin konkret, kriteri i mësipërm e ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik, por në kushte të pabarabarta ka vendosur edhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës/interesuar, pasi nuk u ka dhënë atyre mundësi alternative sikurse parashikon legjislacioni i prokurimit publik, që për vërtetimin e kërkesave të autoritetit të mund të dorëzojnë edhe dokumentacion ekuivalent për ato raste kur është i pamundur sigurimi i dokumenteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar plotësimin e këtij kriteri me disa dokumente të natyrave të veçanta juridike.

Së treti referuar ligjit nr 116/2014 *“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të komformitetit në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 5 e vijues të tij, në asnjë rast nuk parashikohet termi **“ose certifikata aprovimi/performance”**. Në këtë kontekst është e paqartë dhe konfuze mbi mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara apo certifikata aprovimi/performance (term i panjohur nga ligji), siç është kërkuar në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret kërkesat e përcaktuara në kriterin 2.4.4 të mësipërm, e kanë vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik për mallrat e sipërcituar në kriterin 3.4.4, pasi nga njëra anë kërkohet paraqitja e ***raporteve të testimit nga laboratore të akredituar ose certifikata aprovimi/performance***, dokumente për të cilat akoma më tej nuk ka përcaktuar se nga cilat organizma mund të lëshohen. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit duhet të përcaktohen qartë, saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të mos rëndojnë mbi operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta dhe të panevojshme, por të fokusohen në ato kritere, realizimi i të cilave jep një informacion mbi operatorët ekonomikë dhe siguri autoritetit kontraktor, me qëllimin final të përmbushjes me sukses të procedurës së prokurimit. Komisioni thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë. Gjithashtu, Komisioni gjatë shqyrtimit të dokumenteve të tenderit konkretisht procesverbalit *“Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim”* dhe *“Relacionit dhe Specifikimeve teknike”* për të parë sesi autoriteti kontraktor ka kryer argumentimin në lidhje me kërkesat e përcaktuara në kriterin 2.4.4 për sa i përket paraqitjes së kataloget/skdat teknike të shoqeruara me *Çertifikatë Konfirmimit CE/Deklarata Performance* lëshuar nga prodhuesi, për produktet e sipërcituara, rezulton se në procesverbalin e argumentimit të kritereve konkretisht në pjesën e argumentimit të kriterit 2.4.4 konstatohet, se nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar se: *“Ky kriter i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se shumica e produkteve të mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim*

të drejtpërdrejtë në shëndetin e studenteve/pedagogeve etj. Akoma më tej vlerësojmë se kemi të bëjmë me një objekte arsimore ku përpuethshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasoja shëndetësore në shëndetin e studentëve/pedagogeve etj, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, edhe në dokumentin “Relacion dhe Specifikime Teknike Elektrike” konstatohet, se tek informacioni i përgjithshëm i këtij materiali, konkretisht në pikën 1.2 “Qëllimi i Projektit” është përcaktuar se: “**Qëllimi i këtij projekti janë instalimet e sistemeve elektrike dhe elektronike të parashikuara në strukturat e objektit arsimor rikonstruktiv në përputhje me të gjitha ligjet, VKM-të, Standardet, kodet (kushtet teknike) dhe rregulloret teknike në fuqi. Zbatimi me sukses i këtyre specifikimeve dhe kërkesave në përputhje me të gjitha ligjet, VKM-të, Standardet, kodet (kushtet teknike) dhe rregulloret teknike në fuqi dhe respektimi i rekomdheimeve të prodhuesve të pajisjeve dhe materialeve që do të instalohen është detyrë e zbatuesit-kontraktorit. Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet të paraqesë për miratim programin e punës së bashku me metodologjinë për një punë cilësore dhe të sigurt për punishten. Ai duhet të paraqesë për miratim të gjithë elementët e tjerë të nevojshëm për të kryer punën sipas gjykimit të tij ose kërkesave teknologjike**”. Në pikën 3.3. “Specifikimet Teknike” është përcaktuar se: “**Të gjitha kabllot ose përçuesit që do të përdoren duhet të jenë fleksibël. Ato janë tipike për mjediset arsimore. Kabllot dhe përçuesit e izoluar me një material që siguron mbrojtjen e tyre në rast rreziku zjarri, të përmendura në IEC 332.3 mbi kriteret e kërkuara, nuk do të lejojnë shpërndarjen e avujve halogjen dhe gazeve toksike ose tymrave në mjedis (Tym i ulët, pa halogjen - LSHF). Ndërkohë në pikën 3.4.2 “Prizë Elektrike” të po këtij materiali përcaktohet se: “**Priza Schuko, e bardhë dhe e kuqe: 220V, 16A dhe bivalente: 220, 10A. Me fruta - modulare për ambiente arsimore. Në ambiente do të montohen me kuti brenda murit 4 module dhe 3 module sipas rastit përkatës**”, konstaton, se autoriteti kontraktor në objektin e procedurës së prokurimit kërkon të kryejë “Rikonstruksion e Spitalit Rajonal Dibër Rrahim Xhika”, ndërkohë nga sa më sipër cituam vihet re, se si në procesverbalin e arugmentimit të kritereve ashtu dhe tek specifikimet teknike të punimeve, autoriteti kontraktor për hartimin e këtyre kërkesave i është referuar objekteve arsimore, pra qartazi vihet re që përcaktimi i kërkesave të autoritetit kontraktor për paraqitjen e dokumentacionit të të gjitha atyre elementeve të përcaktuara në kriterin 2.4.4 është bërë jo për objekt shëndetësor por për objekt arsimor, objekte këto që për nga natyra dhe funksionaliteti janë të ndryshëm nga njëri tjetri. Këto përcaktime të bëra nga autoriteti kontraktor nuk i shërbejnë objektit të prokurimit, por i kanë shërbyer këtij të fundit si artifica për të kufizuar konkurrencën e operatorëve ekonomikë. Nga sa më sipër cituam, qartazi është e dukshme se autoriteti kontraktor nuk ndodhet përpara një lapsusi në hartimin e kritereve kualifikuese dhe specifikimeve teknike, pasi vullneti i tij parashikohet dhe konstatohet në më shumë se një drejtim dhe episode, pra duke e shprehur vullnetin e tij në hartimin e kritereve kualifikuese dhe specifikimeve teknike abuzuese dhe të ekzagjeruara si te specifikimet teknike të procedurës, ashtu dhe në procesverbalin e argumentimit të kriterit në fjalë 2.4.4. Hartimi i këtyre kërkesave tërësisht të ekzagjeruara, jo të nevojshme dhe të paqarta, shkakton konfuzion jo vetëm tek operatorët por edhe në fazën e vlerësimit. Akoma më tej KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe**

GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kërkesat dhe specifikimet teknike të mësipërme në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e ankesës, duke qenë se arsyeja e skualifikimit të tij është ngritur mbi kërkesa dhe specifikime teknike të hartuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kërkesat për kualifikim por dhe specifikimet teknike nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t'i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës. KPP gjykon, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të tilla që të vendosin të gjithë pjesëmarrësit në pozita barazie duke u ngarkuar të njëjtat të drejta dhe detyrime. Ndërkohë në rastin konkret, autoriteti kontraktor nuk u ka ngarkuar pjesëmarrësve apo personave të interesuar për pjesëmarrje të njëjtat të drejta dhe detyrime, pasi me kërkesat e përcaktuara lënë jashtë pjesëmarrjes një numër shumë të madh ofertuesish. Kriteri sa më sipër është diskriminues, ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe ka për qëllim krijimin e pengesave për pjesëmarrje në procedurë të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur.

III.1.12. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]*”, në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesat e përcaktuara në kriterin e kualifikimit 2.4.4, janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj dhe përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të rishikojë këtë kriter dhe të mbajë në konsideratë përcaktimet e këtij vendimi, duke hartuar kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat reale dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

Duke marrë shkas nga konstatimet e sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nëpërmjet veprimeve të tij, ka vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e prokurimit publik, duke hartuar kriteret dhe specifikime diskriminuese të ekzagjeruara dhe jo në funksion të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, por në funksion të uljes së konkurrencës, ndaj në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për të gjithë zyrtarët përgjegjës për shkeljet e konstatuara.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex General Construction” DSHH për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-ankimi do të anulohet, pretendimet mbi shqyrtimin e arsyeve të tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” DSHH për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-66182-04-14-2023, me objekt: “Rikonstruktion i Spitalit Rajonal Diber ‘Rrahim Xhika’”, me fond limit 325,049,984 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lek pa TVSH, zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, për shkeljet e kryera nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Alko Impex General Construction*” DSHH.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri